



Thirrje për trajnime falas - Promovimi i turizmit rural dhe marketingu i prodhimeve vendore

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë në bashkëpunim me Tourism and Marketing Institute - TMI me përkrahjen e MBPZHR-se, në kuadër të projektit: "Promovimi i turizmit rural dhe marketingu i prodhimeve vendore" fton gratë dhe vajzat nga rajoni i Kamenicës, që merren me prodhime bujqësore, punë dore, artizanate, turizëm rural etj, e që kanë interes aftësi profesionale të aplikojnë për programin e trajnimit dy ditor falas, me qëllim promovimit të punës së tyre, të rritjes së kompetencës profesionale nga kjo fushë si dhe promovimin e prodhimeve vendore.

Kriteret për aplikim:

- Aplikuesit duhet të jenë banorë nga rajoni i Kamenicës, Gjilanit
- Të jenë të gatshëm për të ndjekur trajnimin gjatë gjithë sesioneve
- Të jenë të moshës madhore

Trajnimet mbahen në Kamenice me datë 26 dhe 27 Shtator 2024 ndërsa për vendin dhe orën ju njoftojmë me kohë.

Trajnimet mbahen nga ekspert dhe profesionist të fushës.

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit do të certifikohen për pjesëmarrje

Numri i pjesëmarrësve është i limituar

Aplikimi mund të bëhet në formë elektronike përmes linkut

<https://forms.gle/DLd41CjkrVrqotTY7>

Afati i fundit për aplikim: 25 Shtator 2024

Pjesëmarrëset do të kompenzohen për dy ditë pjesëmarrje në trajnim në shumën prej 10 eurove për mbulimin e shpenzimeve të transportit

Për më shumë mund të na kontaktoni në 043 770220 apo 044 345638

Tmi.kosovo@gmail.com